

Kontrata për Shërbimet e Investimit Online për përdorimin e Platformës së Tregtimit SmartInvest

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a, e regjistruar sipas legjislacionit shqiptarë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. 17469, datë 23.7.1997 dhe ndryshimet pasuese, me NIPT J62001011Q, me seli në adresën: Rruga e Vilave, Lundër 1, Tiranë, (më poshtë referuar si “BKT”), e cila përfaqësohet nga

1. _____, i/e datëlindjes _____ shtetas/e Shqiptar/e, mbajtës/e i/e dokumentit të identifikimit: me Nr. _____, në cilësinë e Degës së BKT-së.
2. _____, i/e datëlindjes _____ shtetas/e Shqiptar/e, mbajtës/e i/e dokumentit të identifikimit: me Nr. _____, në cilësinë e Degës së BKT-së.

Klienti _____, i/e datëlindjes _____, shtetas/e Shqiptar/e, mbajtës/e i/e dokumentit të identifikimit: me Nr. _____, me adresë në _____, është personi fizik në kuptim të Kodit Civil, i cili sipas legjislacionit shqiptar është përdorues i Platformës së Tregtimit Smart-Invest; i cili hyn në marrëdhënie me BKT sipas Kontratës për Shërbimet Investuese për përdorimin e platformës së Tregtisë Smart-Invest.

Të dy së bashku referuar si “Palët”

DEKLARATA PARAPRAKE

- 1) BKT ka përshtatur dhe loguar një sistem tregtimi on-line të një pale të tretë në Evropë, që u mundëson Klientëve të saj të hyjnë në transaksione në tregjet ndërkombëtare për blerjen ose shitjen e monedhave, mallrave ose pasurive të tjera, transaksione me derivative si edhe transaksione të tjera të instrumenteve financiare;
- 2) Klienti i BKT dëshiron të kryejë transaksione për blerjen ose shitjen e monedhave, mallrave dhe pasurive të tjera, derivative si edhe të kryerje transaksione të tjera të instrumentave financiare, duke përdorur Platformën e tregtimit on-line Smart-Invest të BKT-së.
- 3) Kjo Kontratë dokumenton marrëdhëniet midis Palëve dhe përcakton kushtet dhe afatet e rena dakord sipas të cilave Klienti do të angazhohet në shërbimet e tregtimit të investimeve on-line dhe kushtet dhe afatet për çdo Kontratë të lidhur midis Palëve, brenda dhe jashtë Platformës së Tregtimit SmartInvest.
- 4) Kjo Kontratë është lidhur nga dhe ndërmjet BKT dhe Klientit pranues dhe aplikohet për përdorimin e Platformës së Tregtimit Smart-Invest dhe llogaritë e tregtimit nga Klienti.

1. PËRKUFIZIME- INTERPRETIME NË KËTË MARRËVESHJE

Përveçse kur konteksti i Marrëveshjes kërkon apo sugjeron ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijojnë:

‘**Kërkesë/ Ask**’ është çmimi me të cilin Klienti mund të blejë një Kontratë ose një monedhë bazë në një çift (pair) monedhash;

‘**Kodet e Hyrjes**’ është emri i vetëm i përdoruesit, fjalëkalimi dhe kodi i dërguar me mesazh SMS nga BKT tek Klienti për të hyrë në faqen e Internetit të BKT-së, në aplikacionin BKT Smart dhe në platformën e tregtimit të BKT-së Smart-Invest, me hyrje të vetme.

‘Marrëveshje’ do të thote ky dokument i cili do të interpretohet si një dokument që përbën kushtet dhe afatet për të cilin Palët kanë rënë dakord së bashku me Dokumentacionin Ligjor, i disponueshëm në ëbsite në adresën kryesore të BKT-së;

‘Balanci’ do të kuptohet shuma në Llogarinë e Tregimit të Klientit pas transaksionit të fundit të bërë brenda çdo periudhe kohore; Balanci mund të llogaritet: shuma e depozitës minus tërheqje plus krediti plus fitimi i realizuar dhe humbja minus marzhi i kërkuar për Kontratat e hapura;

‘Valuta e Bilancit’ do të thote njësia monetare e monedhës së Bashkimit Evropian, euro, në të cilën caktohen dhe llogariten të gjitha bilancet, tarifat e komisionit dhe pagesat e llogarive të tregimit;

‘Valuta Bazë’ do të thotë monedha e parë në një çift (pair) monedhe;

‘Ofertë/Bid’ do të thotë çmimi që Klienti mund të shesë një kontratë ose monedhe bazë në një çift (pair) monedhe;

“Ditë Biznesi”, do të quhet çdo ditë pune

“Para të gatshme” do të quhen fondet të cilat janë të gatshme për tu tërhequr;

‘Klient’ do të jetë çdo person fizik i cili bie dakord me Kushtet dhe Afatet e përcaktuara këtu;

‘Llogaria e Tregimit të Klientit’ do të jete llogaria e veçantë personale për llogaritjen e brendshme dhe depozitat e konsumatorit, të hapur nga BKT në emër të Klientit. Kushtet dhe Afatet për shërbimet e ofruara nga BKT, mund të përdorin në mënyrë të alternuar fjalën tregtim i llogarisë ose llogari e klientit, të cilët kanë të njëjtin kuptim dhe përdoren për të gjitha llogaritë e tilla tregtare që mbahen nën emrin e Klientit;

‘Pozicion i mbyllur’ është transaksioni i blerjes (shitjes) e mbuluar nga transaksioni i kundërt i shitjes (blerjes) sipas Kontratës;

‘Transaksion i mbyllur’ do të thotë mbyllja e një pozicioni që i referohet ekzekutimit të një transaksioni dhe është e kundërta e një pozicioni të hapur, duke e anuluar atë dhe duke eliminuar ekspozimin fillestar.

‘Kontratë’ do të thotë çdo kontratë për blerjen ose shitjen e ndonjë titulli, monedhe, malli ose pasurie tjetër ose lidhja e ndonjë kontrate derivative (përfshirë, pa kufizim, çdo derivat ose kontratë për ndryshime që i referohet çdo titulli, monedhe, malli ose pasurie tjetër ose matjeje ose indeksi), që i nënshtrohen Kërkesave të Marzhit dhe lidhen mes BKT dhe Klientit, dhe do të përfshijë çdo Kontratë Shkëmbimi dhe Kontratat OTC të ofruara nga BKT në Platformën Smart Invest.

‘Mallra’ lëndet e para ose produktet bujqësore të para që mund të blihen dhe shiten, si bakri, nafta e papërpunuar, misri, kafja etj., si dhe metalet e çmuara.

‘Kontratë për diference’ ose CFD” është një marrëveshje e bërë në tregtimin e derivateve financiare ku diferencat ndërmjet çmimeve të marrëveshjes së hapur dhe mbyllur janë shlyer me para të gatshme.

‘Kapitali’ është pjesa e dhënë e Llogarisë Tregtare të Klientëve, duke përfshirë pozicionet e hapura të cilat janë të lidhura me bilancin dhe luhatjen (Fitimi/Humbja) me formulën e mëposhtme: Balanci + Fitimi -

Humbja. Këto përbëjnë fondet e nën-llogarisë së Klientëve të zvogëluara nga humbja aktuale e pozicioneve të hapura dhe të rritura nga fitimi aktual në pozicionet e hapura;

‘Instrumentat Financiare’ kuptohen të gjithë instrumentet e disponueshëm për tregtim në Platformën e Tregtimit SmartInvest;

‘Luhatjet Fitim/Humbje’ kuptohet fitimi (humbja) e perealizuar e pozicioneve të hapura me çmimet aktuale të monedhave themelore, kontratave ose aksioneve, indekset e kapitalit neto, metale të çmuara ose ndonjë mall tjetër në dispozicion për tregti;

‘Shkëmbimi valutor’ ose **‘Forex’** i referohet tregut të këmbimit valutor, ku tregtohen monedhat e huaja të botës;

‘Marzhi i lire’ kuptohen fondet që nuk përdoren si garanci për pozicionet e hapura, që llogariten si më poshtë: $\text{Marzhi i Lire} = \text{Kapitali} - \text{Marzhi}$;

‘Kontrata e Ardhshme’ ose **FUTURES** është një marrëveshje për të blerë ose shitur një sasi specifike të një aktivi ose një produkti me një çmim të caktuar në një kohë të mëvonshme. Futures është e disponueshme për çdo kategori të pasurive dhe mallrave;

‘Llogaria e Tregtimit Joaktive’ do të kuptohet çdo llogari tregtare e Klientit në të cilën Klienti nuk ka hapur ndonjë pozicion/t dhe/ose ndonjë pozicion të mbyllur/a dhe/ose ka mbajtur në pozicion/t të hapur për një periudhë prej gjashtë (6) muaj;

‘Lot’ është njësi që mat shumën e transaksionit, e barabartë me 100,000 e monedhës baze (prsh 1 lot = 100.000 e monedhës bazë në rastin e një CFD në çifte/pair monedhash);

‘Marzh’ do të kuptohen fondet e nevojshme të garancisë, të transferuara në Llogarinë e Tregtimit të Smart-Invest për të patur një pozicion të hapur në Kontrata, siç përcaktohet në specifikimin e Kontratave;

‘Balanci i Marzhit’ do të thote që, në çdo kohë, vlera e përgjithshme e Marzhit e transferuar tek ose marrë nga Platforma SmartInvest e BKT në perputhje me këtë Marrëveshje (e vlerësuar në perputhje me këtë Marrëveshje) si e zvogëluar herë pas herë në perputhje me këtë Marrëveshje;

‘Niveli i Marzhit’ do të kuptohet indeksi që karakterizon llogarinë, e llogaritur si: $\text{Kapital} / \text{Marzh}$;

‘Marzhi i Kërkuar’ është shuma e përgjithshme e Marzhit e kërkuar nga BKT nga Klienti në lidhje me Kontratat e tregtimit në Llogarinë e Tregtimit Smart-Invest të vendosura në diskrecionin e vetëm të BKT;

‘Të Dhëna të Tregut’ do të kuptohet çdo e dhënë financiare ose e Tregut e dhënë nga BKT, duke përfshirë por pa u kufizuar në të dhëna çmimesh qoftë në kohë reale, me vonesë ose të çmimeve në fund të ditës, dhe çdo lloj instrumenti, master data ose lloje të tjera të të dhënave referuese, të dhëna vëllimi, analizave të thelluara dhe përmbajtje;

‘Burimet e të Dhënave të Tregut’ janë burimet nga të cilat burojnë të dhënat e tregut, zakonisht një shkëmbim ose një ofrues shkëmbimi si NYSE, NASDAQ, BATS EURO dhe të ngjashme;

‘Kapitali i Lire Neto’ nenkupton (i) pozicionin e parave cash në llogarinë e tregtimit Smart-Invest (ii) plus ose minus vlerën e çdo fitimi ose humbjeje të perealizuar (sipas rastit) nga Kontratat në llogarinë e tregtimit Smart-Invest, (iii) minus vlerën e Marzhit të Kërkuar;

‘Pozicion i hapur’ do të kuptohet marrëveshja e blerjes (shitjes) e cila nuk mbulohet nga shitja e kundert (blerja) e kontrates;

‘Koha e Funkcionimit (Tregtimit) e platformës SmartInvest’ do të jetë periudha e kohës brenda një jave pune, ku terminali i tregtimit të SmartInvest ofron mundësinë e operacioneve të tregtimit me instrumente financiare. BKT rezervon të drejtën të ndryshojë këtë periudhë si të jetë e përshtatshme, pasi të jetë njoftuar në adresën kryesore të internetit të Kompanisë;

‘Urdhër’ do të thotë kërkesa për ekzekutimin e transaksionit;

‘Kontrata mbi banak (OTC)’ janë kontrata midis dy palëve (marrëveshje dypalëshe) pa ndërhyrjen e një ndërmjetësi;

‘Transaksion i hapur’ do të quhet një transaksion spekulativ ose një transaksion i cili nuk është mbyllur.

‘Pale’ do të thotë çdo degë e BKT-së dhe Klienti dhe "Palët" do të interpretohen në përputhje me rrethanat;

‘Urdhri në pritje’ do të thotë një urdhër për blerje ose shitje në një sasi në një nivel çmimi të caktuar;

‘Diferencë çmim Blerje/shitje’ do të thotë ndryshimi midis çmimit të blerjes së Kërkesës dhe çmimit të shitjes së Ofertës së instrumenteve financiare në të njëjtin moment;

‘Aksionet’ janë njësi të pronësisë së një kompanie, që zakonisht tregtohen në tregun e aksioneve. Ato njihen edhe si kapitale.

‘Tregu i Aksioneve/Bursave- Stock’ dhe **‘Tregtimi i Aksioneve’** është një treg në të cilin letrat me vlerë blihen dhe shiten;

‘Stop’ jashtë nivelit - pozicioni i tillë i llogarise kur pozicionet e hapura mbyllen me forcë nga SmartInvest me çmime aktuale për shkak të marzhit të kërkuar;

‘Ndalim Humbje’ është urdhri në pritje që i bashkëlidhet një pozicioni të hapur ose një urdhri tjetër në pritje për mbylljen e një pozicioni, zakonisht me humbje;

‘Sub account’, është një llogari e veçuar e vendosur brenda një llogari më të madhe.

‘Take Profit’ do të kuptohet çdo urdhër në pritje që i bashkangjitet një pozicioni të hapur ose urdhëra të tjerë në pritje për mbylljen e pozicionit, zakonisht me një fitim;

‘Llogaria e Tregtimit’ do të kuptohet llogaria e dhënë nga BKT, me një numër unik, e mbajtur nga një Klient, për qëllime të tregtimit të instrumenteve financiare përmes Platformës së Tregtimit SmartInvest;

‘Transaksion’ do të kuptohet çdo lloj transaksioni që kryhet në Llogarinë/të e Tregtimit të Klientëve, duke përfshirë por pa u kufizuar në Depozita, Tërheqje, Transaksione të Hapura, Transaksione të Mbyllura.

2. DEKLARIME TË RISKUT

2.1. Paralajmërimi të Riskut

Tregtimi i produkteve dhe shërbimeve të BKT SmartInvest mund të rezultojë në humbje, si dhe në fitime. Veçanërisht, tregtia në produkte me mundësi të larta fitimi siç mund të jetë, por pa u kufizuar, këmbimi

valutor, derivatet dhe mallrat, mund të jetë shume spekulative, kështu që humbjet dhe fitimet mund të luhaten në mënyrë të qenësishme dhe të shpejtë. Tregtia spekulative nuk është e përshtatshme për të gjithë investitorët.

Tregtimi i produkteve financiare përfshin gjithmonë një rrezik. Për këtë arsye, si rregull i përgjithshëm, ju duhet të tregtoni produkte financiare vetëm nëse i kuptoni produktet dhe rreziqet që lidhen me to.

Nëse përmenden në një publikim rreziqet që i perkasin një produkti ose shërbimi të caktuar, kjo nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si një deklarament ose përshkrim i plotë i të gjitha rreziqeve që i perkasin një produkti ose shërbimi të tillë dhe BKT nxit fort çdo marrës që po konsideron tregtimin e produkteve dhe shërbimeve të tij të punësojë dhe të konsultohet vazhdimisht me këshilltarët e përshtatshëm financiarë përpara përfundimit të ndonjë investimi ose transaksioni.

Klienti deklaron se ai/ajo ka lexuar, kuptuar dhe pa kushte pranon si vijon:

- a. Informacioni mbi performancën e mëparshme të një Instrumenti Financiar dhe Kontratave përkatëse nuk garantojnë performancën e tij aktuale dhe/ose të ardhshme. Përdorimi i të dhënave historike nuk përben një parashikim detyrues ose të sigurt për sa i përket performancës përkatëse të ardhshme të Instrumenteve Financiare, të cilave u referohet informacioni në fjalë.
- b. Disa Instrumente Financiare nuk mund të bëhen menjëherë likuide si rezultat p.sh. i kërkesës së ulur dhe Klienti mund të mos jetë në pozicion t'i shesë ato ose të marrë lehtësisht informacion mbi vlerën e këtyre Instrumenteve Financiare ose shtrirjen e rreziqeve të shoqëruara.
- c. Kur një Instrument Financiar tregtohet në një monedhe tjetër të ndryshme nga monedha e vendit të Klientëve, çdo ndryshim në kurset e këmbimit mund të ketë një efekt negativ në vlerën, çmimin dhe performancën e tij.
- d. Një Instrument Financiar në tregjet e huaja mund të sjellë rreziqe të ndryshme nga rreziqet e zakonshme të tregjeve të vendeve të Klientëve. Në disa raste, këto rreziqe mund të jenë më të mëdha. Perspektiva e fitimit ose humbjes nga transaksionet në tregjet e huaja ndikohet gjithashtu nga luhajtjet e kursit të këmbimit.
- e. Instrumentet Financiare të ofruar nga Platforma e Tregtimit SmartInvest e BKT-së, janë transaksione Spot FOREX, Forward FOREX, Kontratave të së Ardhmes, Kontratave për Diferencë (CFD), Indekset e Kontratave për Diferencë, Kontratave për Diferencë të Mallrave dhe të Aksioneve. Instrumentat financiarë të ofruar janë transaksione jo-dorëzuese me përjashtim të aksioneve të kapitalit të cilat janë dorëzuese. Kontrata CFD, të japin mundësi për të tregtuar në ndryshimet në kurset e monedhës, mallrave, indekset e tregut të aksioneve ose çmimet e aksioneve, të quajtura instrumente themelore.
- f. Vlera e Instrumenteve Financiare ndikohet drejtpërdrejt nga çmimi i aktivitetit financiar ose ndonjë aktivitet tjetër themelor objekt i blerjes.
- g. Klienti nuk duhet të blejë Instrumente Financiare përveç nëse ai/ajo është i gatshëm të ndërmarë rreziqet e humbjes së një pjese të konsiderueshme të parave që ai/ajo ka investuar, gjithashtu edhe komisionet shtesë dhe shpenzimet e tjera të bëra.

2.2. Kufizimet Rregullatore Vendase

Website i BKT-së dhe informacioni në lidhje me Platformën e Tregtimit SmartInvest mund të aksesohen në të gjithë botën. Megjithatë, informacioni i ofruar në këto Publikime, ka për qëllim të përdoret vetëm nga përdorues rezidentë në Shqipëri, ku një përdorim i tillë nuk përben shkelje të legjislacionit ose rregulloreve në fuqi. Asnjë nga produktet dhe shërbimet e përmendura në Publikimet e BKT-së nuk janë në dispozicion për marresit që banojnë në vendet ku sigurimi i produkteve dhe shërbimeve të tilla mund të përbejë shkelje të legjislacionit ose rregulloreve të detyrueshme vendore të zbatueshme.

Është përgjegjësia e vetme e Klientit i cili kërkon të përdorv dhe të tregtojë Platformën e Tregtimit Smart Invest që të respektojë të gjithë legjislacionin ose rregulloret në fuqi.

2.3.Përdorimi i Website

BKT nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet ose dëmtimet që vijnë nga aksesi i ndonjë personi ose entiteti, ose pamundësia për të hyrë në ndonjë faqe on-line të Grupit Saxo Bank. Ky kufizim përfshin, por pa u kufizuar, ndonjë dëmtim të pajisjeve kompjuterike dhe sistemeve kompjuterike të shkaktuara nga virusi, malware dhe çdo kodim tjetër i dëmshëm kompjuterik.

3. - DEKLARIME DHE MIRATIME TË KLIENTIT

Pa kufizuar në sa me sipër, Shërbimet e përfshira në Platformën e Tregtimit Smart Investor, janë të përshtatshme vetëm për Klientët të cilët janë në gjendje të përballojnë humbjen e një pjese të konsiderueshme të parave që investojnë, të cilet kuptojnë rreziqet dhe kanë përvojë në marrjen e rreziqeve të përfshira në tregjet financiare. Ekziston mundësia që Klienti mund të përballojë një humbje të një pjese ose në raste ekstreme të gjithë investimit të tij/saj fillestar dhe për këtë arsye Klienti nuk duhet të investojë para të cilat nuk mund të përballojë t'i humbasë.

3.1.Klienti solemisht deklaron këtu se:

- a. ka lexuar me kujdes, kuptuar plotësisht dhe pranuar të gjithë tekstin e kësaj Marrëveshjeje dhe kushtet dhe afatet e tij, të cilat ai/ajo i respekton plotësisht dhe pa kushte për përdorimin e Platformës së Tregtimit SmartInvest;
- b. ka lexuar të gjitha informacionet e vëna në dispozicion në faqen zyrtare të BKT-së në lidhje me Platformën e Tregtimit Smart-Invest, shërbimet e ofruara, detyrimet për të përmbushur, kushtet e shërbimeve të ofruara, tarifat dhe komisionet dhe çdo kosto tjetër përkatëse;
- c. është njohës shumë i mirë i gjuhës në angleze ose italiane, ose i të dyjave, duke qenë kështu në gjendje të kuptojë të gjitha udhëzimet, shpjegimet, afatet, kushtet dhe tarifat dhe të ngjashme me qëllim të përdorimit të Platformës së Tregtimit Smart-Invest e cila ofrohet vetëm në gjuhët angleze ose italiane. Herën e parë kur Klienti do të hyjë në Platformën e Tregtimit Smart-Invest, Klienti do të njoftohet të zgjedhë gjuhën (anglisht ose italisht) në të cilën dëshiron të përdorë Platformën e Tregtimit Smart-Invest.
- d. ai/ajo kërkon të lidhet me Platformën e Tregtimit Smart-Invest në mënyrë që të përfitojë nga të gjitha shërbimet e investimit dhe aktivitetet e ofruara nga Platforma e Tregtimit SmartInvest, me iniciativën dhe vullnetin e vet.
- e. është në gjendje të përballojë humbjen e një pjese të konsiderueshme të parave që investon ose në raste ekstreme të gjithë investimin e tij/saj fillestar.
- f. kuptojnë rreziqet dhe ka përvojë në marrjen e rreziqeve të përfshira në tregjet financiare.

3.2.Klienti solemisht jep pëlqimin dhe është dakort që:

- a) të marrë reklama të drejtpërdrejta përmes thirrjeve nga marketingu, qoftë me telefon ose fizikisht, faksimile, thirrje automatike, email ose mjete të tjera telefonike, elektronike ose dixhitale nga BKT.
- b) Platforma e Tregtimit Smart-Invest do të veprojë si Agjent i Klientit dhe nuk do të veprojë në emër dhe për llogari të Klientit në lidhje me urdhërat që ai/ajo do të vendosë me Platformën e Tregtimit Smart-Invest për Kontratat e ofruara nga Platforma e Tregtimit Smart-Invest.

4. QËLLIMI I MARRËVESHJES

- 4.1. Kjo Marrëveshje do të rregullojë të gjitha veprimet në lidhje me përdorimin e Platformës së Tregtimit Smart-Invest dhe me ekzekutimin e porosive dhe transaksioneve të Klientit për tregtimin on-line në platformë.
- 4.2. Kjo Marrëveshje është e panegociueshme dhe mbizotëron mbi çdo marrëveshje tjetër të mëparshme.

5. OFRIMI I SHËRBIMEVE

5.1. Kushtet e Përgjithshme

BKT do t'ju mundësojë klientëve akses për t'u përfshirë në tregtimin e investimeve on-line përmes Platformës së Tregtimit Smart-Invest sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha Kontratat e lidhura midis Palëve, përmes Platformës së Tregtimit Smart-Invest, do të jenë Kontrata që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Marrëveshjes ISDA (siç është e zbatueshme) që BKT ka bërë me palët e treta në Europë, përveç nëse parashikohet ndryshe me shkrim.

- 5.1.1. Shërbimet e investimeve on-line që do të ofrohen nga Platforma e Tregtimit Smart-Invest për Klientin janë si vijon:

Pritja, transmetimi dhe ekzekutimi i Urdhrave të investimeve në lidhje me transaksionet financiare Kontratat kanë objekt një ose më shumë nga Instrumentet Financiare të mëposhtem:

- Spot FOREX, Kapitali neto, metale të çmuara dhe çdo Kontratë tjetër e Instrumenteve Financiare;
- Kontratat e së Ardhmes dhe të gjitha Kontratat e tjera derivative në lidhje me letrat me vlerë, monedhat, mallrat, normat e interesit ose rendimentet ose instrumente të tjera derivative, indekset financiare ose masat financiare që mund të shlyhen fizikisht ose në para;

- 5.1.2. Klienti pranon që Platforma e Tregtimit Smart-Invest ose ndonjë material tjetër i BKT-s, nuk përfshin në asnjë rrethanë dhënien e ndonjë keshille për investime, qoftë të nënkuptuar apo të shprehur, verbale apo të shkruar. Çdo informacion mbi investimet siç mund të njoftohet nga BKT për Klientin, nuk përbën ndonjë keshille për investime, por synon vetëm të ndihmojë Klientin në investimet e tij/saj financiare. Asnjë informacion i dhënë nga BKT nuk konsiderohet si një garanci për rezultatet e pritura të ndonjë transaksioni.

- 5.1.3. Klienti pajtohet dhe pranon që ai/ajo është përgjegjësi i vetëm për çdo strategji investimi, transaksion ose investim, përbërjen e çdo llogarie dhe pasojat e tatimeve dhe ai/ajo nuk do të mbështetet, për këtë qëllim tek BKT. Kuptohet dhe pranohet gjithashtu nga Klienti që BKT nuk mban absolutisht asnjë përgjegjësi, pavarësisht nga rrethanat, për çdo strategji, transaksion, investim ose informacion të tillë.

- 5.1.4. Klienti është i informuar që për çdo Urdher të vendosur brenda Platformës së Tregtimit Smart-Invest për Instrumentet Financiare të ofruara nga platforma, Platforma e Tregtimit Smart-Invest vepron si Agjent dhe jo në emër e për llogari të Klientëve.

6. KUJDESTARIA

- 6.1. Çdo para cash që mban BKT në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë paratë e kredituara në Llogarinë e Tregtimit për kryerjen e transaksioneve në platformën SmartInvest, do të mbahen nga BKT ose mund të transferohen tek palët e treta në Europë si kolateral i transaksioneve financiare të cilat do të kryheshin nga Klienti.

- 6.2.** BKT do të (dhe Klienti njih dhe pranon që BKT) veprojnë si kujdestar dhe mund, duke iu nënshtruar Aktit të Biznesit Financiar, të emërojnë çdo person tjetër, përfshirë një Bashkëpunëtor, si nën-kujdestar, ose në rast të kundërt të mbajë ose regjistrojë Titujt e Klientit Institucional, duke përfshirë dokumentet e titullit ose çertifikatat që dëshmojnë titullin. Për këtë qëllim, BKT mund të hapë llogari me dhe të depozitojë Titujt në Saxo Bank A/S, Danimarkë dhe cilindo nën-kujdestar. BKT do të ushtrojë me kujdes detyren në përzgjedhjen, emërimin dhe rishikimin periodik të nën-kujdestareve ashtu siç kërkohet.
- 6.3.** Kur Titujt mbahen në emër të një Klienti jashtë, ato mund të jenë subjekt i zgjidhjeve të ndryshme, kërkesave ligjore dhe rregullatore dhe praktikave të ndryshme për identifikimin e Titujve, siç aplikohen në Zonën Ekonomike Europiane (EEA), në këtë rast, të drejtat e Klientit për këto Tituj mund të ndryshojnë në varësi të juridiksionit në të cilin janë mbajtur.
- 6.4.** BKT do të bëjë përpjekjet e saj më të mira që çdo nën-kujdestar të mbajë shënime të sakta në lidhje me të gjitha transaksionet e kryera nga BKT me Klientët
- 6.5.** Klientët pranojnë që BKT dhe nën-kujdestari i saj mund të mbajnë Tituj në një llogari, e cila gjithashtu mban Tituj të klientëve të tjerë të BKT (llogari omnibus). Në përputhje me rrethanat, Tituj të tilla do të regjistrohen në emrin e BKT dhe BKT do të mbajë një librezë që tregon interesin e Klientit në të.

7. URDRAT- UDHËZIMET

- 7.1.** Klienti, duke përdorur Platformën e Tregimit Smart- Investor, mund të japë vetëm urdhërat e mëposhtme të karakterit tregtar:
- i. HAP – për të Hapur një Pozicion
 - ii. MBYLL – për të Mbyllur një Pozicion të Hapur
 - iii. Për të shtuar, hequr, modifikuar urdhërat për Stop Loss, Take Profit, Buy Limit, Buy Stop, Sell Limit, dhe Sell Stop. Asnjë urdher tjetër nuk është i disponueshëm.
- 7.2.** Ekzekutimi i Urdhërave: Urdhërat e konfirmuar të tregut për pozicion Open (Hap) ose Close (Mbyll) do të ekzekutohen menjëherë dhe automatikisht. Urdhërat mund të vendosen, ekzekutohen, ndryshohen ose hiqen në çdo kohë në platformën SmartInvest, por nuk mund të ekzekutohen nëse tregjet përkatëse financiare nuk janë të hapura. Vetëm brenda kohës së funksionimit (tregtimit) të tregjeve përkatëse financiare, urdhërat mund të ekzekutohen dhe nëse nuk ekzekutohen do të mbeten efektive gjatë seancës tjetër tregtare. Urdhri i Klienteve do të jetë i vlefshëm në përputhje me llojin dhe kohën e Urdhrit të dhënë, siç specifikohet. Nëse koha e vlefshmërisë së Urdhrit nuk specifikohet, ajo do të jetë e vlefshme për një periudhë të pacaktuar.
- 7.3.** Në kushte të caktuara tregtare, kur nuk ka likuiditet të mjaftueshëm në tregjet financiare, mund të jetë e pamundur të ekzekutohen urdhërat (Stop Loss, Take Profit, Buy Limit, Buy Stop, Sell Limit, and Sell Stop) në çdo Instrument Financiar në çmimin e deklaruar të urdhërit. Në këtë rast, BKT rezervon të drejtën, në diskrecionin e saj, të ekzekutojë porosinë me çmimin e parë të disponueshëm në tregjet financiare.
- 7.4.** Ngjarjet që mund të shkaktojnë veprimet e përmendura në nenin 6.3 në emër të Platformës së Tregimit SmartInvest, konsiderohen të jenë si vijon (pa u kufizuar ne):
- i. Në momentet e lëvizjes së shpejtë të çmimeve nëse çmimi rritet ose bie në një sesion tregtimi në atë masë sa që sipas rregullave të shkëmbimit përkatës, tregtimi pezullohet ose kufizohet.
 - ii. Në momentin e fillimit të sesionit të tregtimit që ka si rezultat, vendosjen e një Urdhri Stop-Loss nuk do të kufizojë domosdoshmërisht humbjet e Klientit në shumat e parashikuara, sepse kushtet e tregut mund ta bejnë të pamundur ekzekutimin e një porosie të tillë me çmimin e përcaktuar.

8. MARZHI DHE SHPËRNDARJA/SPREAD

- 8.1.** Marzhi i Kërkuar i aplikueshëm do të përcaktohet nga BKT dhe mund të ndryshohet në çdo kohë. Në këtë mënyrë, BKT rezervon të drejtën të ndryshojë volitshmërinë/leverage të Llogarisë së Tregtimit të Klientit sipas gjykimit të saj, qoftë për një periudhë të kufizuar ose të përhershme kohore. BKT nuk është e detyruar të njoftojë veçmas Klientin për çdo ndryshim të Marzhit të Kërkuar, por BKT do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të informuar Klientin për çdo ndryshim të planifikuar në Marzhin e Kërkuar përmes postës elektronike, përmes Platformës së Tregtimit SmartInvest ose në website para se të zbatohen ndryshimet.
- 8.2.** Klienti, në çdo kohë, është i detyruar të ruajë një Bilanc të Marzhit të barabartë ose më të madh se Marzhi i Kërkuar, i zbatueshëm për Klientin, në çdo kohë.
- 8.3.** BKT mund, por nuk është i detyruar ta njoftojë Klientin nëse Balanca e Marzhit, në çdo kohë, është i pamjaftueshëm për të mbuluar Marzhin e Kërkuar (një "Thirrje e Marzhit"/ a "Margin Call"). Klienti duhet menjëherë, ose brenda një afati tjetër kohor siç mund të specifikohet nga BKT, të sigurojë që Balanca e Marzhit të jetë e mjaftueshme për të mbuluar Marzhin e Kërkuar, duke (i) depozituar Marzhin e Kërkuar në Platformën e Tregtimit SmartInvest dhe/ose (ii) uljen e ekspozimit të hapur.
- 8.4.** Në çdo kohë, nëse Niveli i Marzhit bie në "Zero" në Platformën e Tregtimit SmartInvest për shkak të ekspozimit të hapur të Klientit, Platforma e Tregtimit SmartInvest do të mbyllë automatikisht të gjitha pozicionet e hapura sipas çmimit të tregut në atë moment.
- 8.5.** BKT ka të drejtë, në diskrecionin e saj, të rrisë ose ulë shpërndarjet në Instrumentet Financiare në varësi të kushteve të tregut, pa njoftuar paraprakisht Klientin;
- 8.6.** Në çdo ditë, kur Bilanci i Marzhit tejkalon Marzhin e Kërkuar (një tepëri e tillë referuar si "Bilanci i tepërt"), Klienti mund të kërkojë të tërheq para nga Platforma e Tregtimit SmartInvest, përsëri në llogarinë e tij aktuale dhe të transferojë Marzhin Ekuivalent me një vlerë të barabartë me Bilancin e Tepërt ndaj Klientit (një "Kthim i Marzhit").

9. TARIFAT DHE TAKSAT

- 9.1.** BKT përmes Platformës së Tregtimit SmartInvest ka të drejtë të marrë tarifa nga Klienti për shërbimet e përshkruara në këtë Marrëveshje si dhe kompensim për shpenzimet që do të bëjë për detyrimet që do të ndërmarrë gjatë ekzekutimit të shërbimeve të përmendura. BKT rezervon të drejtën për të modifikuar, herë pas here, masat, shumat dhe përqindjet e tarifave të tij, një modifikim i tillë do të publikohet në website kryesor, publik të BKT për të gjithë klientët e saj.
- 9.2.** Të gjitha produktet financiare të ofruara në Platformën e Tregtimit SmartInvest nuk janë produkte që ofrojnë të ardhura nga interesi për Klientin. Rrjedhimisht, të gjithë fitimet e përfituara nga blerja/shitja e produkteve financiare në Platformën e Tregtimit SmartInvest, duhet të raportohen nga Klienti në deklaratën e të ardhurave personale dhe është përgjegjësia e vetë Klientit t'i raportojë ato fitime/të ardhura.
- 9.3.** Klienti do të paguaj BKT, menjëherë kur kërkohet nga kjo e fundit dhe BKT ka të drejtë të debitojë llogarinë e Klientit me çdo lloj tatimi që lidhet me aktivitetet e Klientit në Platformën e Tregtimit SmartInvest, kontribut ose tarifë që mund të paguhet si rezultat i çdo transaksioni që ka të bëjë me Klientin ose ndonjë veprim të BKT sipas Marrëveshjes.

10. UDHËZIME DHE MBROJTJA E FJALËKALIMIT

- 10.1.** Klientët të cilët kanë qasje në Platformën e Tregtimit Smart-Invest, do të përdorin Kodin e Hyrjes unik për të siguruar që ai/ajo është përdoruesi i vetëm i parave dhe llogarive të tij/saj. Kodet e Hyrjes nuk duhet të ndahen me palë të treta. Klienti duhet të respektojë këtë detyrim dhe Klienti është përgjegjës ndaj BKT dhe Burimeve të të Dhënave të Tregut për çdo kosto shtesë si rezultat i shkeljes së bërë.
- 10.2.** Klienti do të informojë BKT menjëherë për çdo hyrje të paautorizuar në Platformën e Tregtimit SmartInvest ose ndonjë udhëzim të paautorizuar.
- 10.3.** BKT nuk do të jetë përgjegjës ndaj Klientit për Kontratat e lidhura në bazë të një udhëzimi i cili duket të jetë bërë nga një Hyrje e Autorizuar ose që BKT në mënyrë të arsyeshme beson se është kryer nga një Hyrje e Autorizuar, edhe nëse udhëzimi i tillë është rezultat i Hyrjes së paautorizuar ose përdorimit të gabuar.
- 10.4.** Klienti pranon që hyrja elektronike në sisteme mund të mos jetë e sigurt. BKT nuk mban asnjë përgjegjësi për shkelje të sigurisë, me përjashtim të rasteve kur ajo vjen nga pakujdesia e rëndë, sjellja e gabuar ose mashtrimi i BKT-së.

11. DHËNIA E LICENCËS DHE TË DREJTAT E PRONËSISË

- 11.1.** BKT ju garanton Klientëve një të drejtë personale, jo-ekskluzive për të hyrë dhe përdorur Platformën e Tregtimit me qëllimin e vetëm për të përmbushur nevojat dhe qëllimet e transaksioneve financiare të Klientit sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
- 11.2.** Klienti nuk mund të përdor platformën SmartInvest për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar në këtë Marrëveshje me përjashtim të rastit kur është rënë dakord me shkrim ndërmjet Palëve, dhe Klienti nuk do të lejojë asnjë palë të tretë të përdor Platformën e Tregtimit SmartInvest ose të përdor platformën në emër të ose për përfitimin e ndonjë pale të tretë në çfarëdo mënyre (duke përfshirë përdorimin e Platformës së Tregtimit SmartInvest me qëllim të funksionimit të një shërbimi zyre, shërbimi të menaxhimit të objekteve, shërbimit të jashtëm ose ndonjë marrëveshje tjetër të paautorizuar).
- 11.3.** Platforma e Tregtimit dhe çdo e drejtë e lidhur me Pronësinë Intelektuale mbetet pronë ekskluzive e BKT ose licencuesve të saj në çdo kohë. Për më tepër, Klienti nuk ka akses në kodin burimor të Platformës së Tregtisë.
- 11.4.** Klienti nuk do të dekodojë në asnjë lloj mënyre Platformën e Tregtimit Smart Investor.

12. DËMSPËRBLIMI DHE PËRGJEGJËSIA

- 12.1.** Brenda kufijëve të lejuar nga ligji, Klienti do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe mbajë të padëmtuar BKT nga humbjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo pretendim aktual ose kërcënim nga një Underlying Client kundër BKT, përveç kur vijnë si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të qëllimshme ose nga pakujdesia e rëndë e BKT.
- 12.2.** Klienti përdor Platformën e Tregtimit SmartInvest duke marrë përsipër i vetëm rrezikun dhe BKT nuk është përgjegjëse për përdorimin e Platformës së Tregtimit SmartInvest. Platforma e Tregtimit SmartInvest dhe përmbajtja e saj është dhënë "siç është" dhe BKT nuk merr përsiper funksionalitetin ose përshtatshmërinë e Platformës së Tregtimit SmartInvest për Klientin, ose që platforma do të jetë e pandërprerë ose pa gabime. Të gjitha kushtet, garancitë, premtimet, deklaratimet dhe sipërmarrjet që mund të nënkuptohen, qoftë sipas ligjit, qoftë ndryshe, në lidhje me detyrimet e mëposhtme të BKT-së, janë të përjashtuara në masën maksimale të lejuar me ligj. Klienti pranon që ndonjë informacion në Platformën e Tregtimit SmartInvest mund të jetë i pasaktë, i paplotë dhe/ose i papërditesuar.
- 12.3.** Platforma e Tregtimit SmartInvest do të perfundojë transaksione në mirëbesim dhe me kujdesin e duhur, por nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë mosveprim, mosveprim të qëllimshëm ose mashtrim

nga ndonjë person, firmë ose kompani prej së cilës Platforma e Tregtimit SmartInvest merr udhëzime për ekzekutimin e Urdhrave të Klientit dhe/ose nga i cili kryhen transaksione në emër të Klientit, përveç nëse kjo do të ishte rezultat i pakujdesisë, mosveprimit të qëllimshëm ose mashtrimit e ofruar përmes Platformës së Tregtimit SmartInvest të BKT-së.

- 12.4. BKT nuk do të jetë përgjegjëse për, dhe nuk jep garanci në lidhje me, performancën ose përfitimin e Kontratave të nënshkruara nga Klienti.
- 12.5. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton ose kufizon asnjë përgjegjësi që BKT nuk mund ta përjashtojë ose kufizojë në përputhje me Ligjin e zbatueshëm. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të kërkojë që Klienti ose BKT të dëmshpërblejnë Palën tjetër, kur dhenia e një dëmshpërblimi nuk do të jetë në përputhje me ligjin në fuqi ose kërkesat rregullatore.

13. PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË TREGUT

- 13.1. Çdo e Dhënë e Tregut e marrë përmes Platformës së Tregtimit Smart-Invest është rreptësisht për shfaqje vetëm në Platformën e Tregtimit Smart-Invest; asnjë përdorim tjetër nuk lejohet. Shpërndarja e të Dhënave të Tregut, në asnjë rrethanë, nuk lejohet pa lejen të shprehur me shkrim të BKT-së. Të Dhënat e Tregut, në asnjë rrethanë, nuk duhet të përdoren për qëllime të paligjshme.
- 13.2. Klienti kupton dhe pranon se Burimet e të Dhënave të Tregut mund të ndryshojnë termat, tarifat dhe politikat e tyre herë pas here. Është përgjegjësia e vetme e Klientit që të respektojë politikat e Burimeve të të Dhënave të Tregut.
- 13.3. BKT mund të ndërpresë çdo shërbim të të Dhënave të Tregut menjëherë duke përfshirë, por pa u kufizuar në rastin kur një Burim i të Dhënave të Tregut ka kërkuar një gjë të tillë, kur ka ndonjë mospërputhje me kushtet e veçanta të përfundimit të secilit Burim të të Dhënave të Tregut.
- 13.4. BKT nuk shet të Dhënat e Tregut, por thjesht vepron si një lehtësues për burime të ndryshme të të dhënave të tregut. Klienti mund të abonohet tek Burimet e të Dhënave të Tregut me shpenzimet e veta duke përdorur butonat “Llogari / Tjetër / Abonim” përmes Platformës së Tregtimit Smart Investor.
- 13.5. Për abonimin në të Dhënat e Tregut, Klientëve u kërkohet të japin të dhënat e abonuesve (të dhënat dhe informacionet e tyre) që duhet të jenë të plota dhe korrekte në çdo kohë. BKT ka të drejtën, që në çdo kohë, të gjykojë deklaratën e abonuesit/Klientit dhe të dhënat e abonuesve/Klientëve si të pamjaftueshme ose të pasakta.

14. KUSHTET E VEÇANTA TË TREGUT DHE FORCA MADHORE

- 14.1. BKT ka të drejtë, sipas mendimit të saj të arsyeshëm profesional, të percaktojë nëse ekziston një situatë emergjente ose e kushteve përjashtimore të tregut. Kushte të tilla përfshijnë, por pa u kufizuar në, pezullimin ose mbylljen e ndonjë tregu, anulimin ose moskryerjen e ndonjë veprimi me të cilën BKT i referohet kuotimeve të saj ose ndodhja e një lëvizjeje të tepruar në nivelin e ndonjë transaksioni dhe/ose tregu themelor ose sipas parashikimit të arsyeshëm të BKT për ndodhjen e një lëvizjeje të tillë. Në raste të tilla, BKT ka të drejtë të rrisë Marzhin e Kërkuar, dhe/ose të përfundojë dhe mbyllë disa ose të gjitha Kontratat e hapura të Klientit, në përputhje me pikën 8 (Marzhi dhe Shpërndarja) dhe/ose të pezullojë ose modifikojë zbatimin e të gjithave ose ndonjë prej kushteve të kësaj Marrëveshjeje pa njoftuar Klientin.

Pa cënuar parashikimet e pikës së mësipërme, nëse dhe në atë masë që, BKT pengohet nga rrethanat që nuk mund t'i parashikojë në mënyrë të arsyeshme dhe që nuk mundet brenda aftësive të saj të arsyeshme, të kontrollojë nga kryerja e ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, atëherë BKT do të lirohet nga përgjegjësia ndaj të tjerëve për mospërmbushje të këtyre detyrimeve, por megjithatë do të bëjë të gjitha përpjekjet për të rifilluar realizmin e plotë të këtyre detyrimeve pa vonesa. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë ndonjë vështirësi teknike, siç janë telekomunikacioni ose dëmtimet e kompjuterit ose ndërprerjet, padisponueshmëria e Website,

dështimi i çdo këmbimi, clearing house ose zgjidhjeve, lufta e deklaruar ose e pashmangshme, terrorizmi, trazira civile ose katastrofa të natyrës. Për shmangien e dyshimit, mungesa e fondeve financiare nuk do të konsiderohet asnjëherë si një justifikim i paparashikueshëm dhe/ose i pakontrollueshëm.

15. DEKLARIMET DHE GARANCITË

- 15.1. Nëse klienti është person fizik, Klienti përfaqëson dhe garanton si më poshtë: Klienti nuk është një person amerikan ose një klient amerikan (secili siç referohet në Komisionin e Tregtisë së Futurës të Sh.B.A. ("CFTC")) **Interpretues ndërkufitar Udhëzimesh (Cross-Border Interpretive Guidance)** siç zbatohet herë pas here, dhe interpretohet në rregulla, udhëzime dhe urdhëra të lëshuara nga CFTC herë pas here;
- 15.2. BKT deklaron dhe garanton si më poshtë:
1. BKT është themeluar në mënyrë të vlefshme sipas Ligjeve të juridiksionit ku është themeluar dhe nëse është e aplikueshme në bazë të këtyre Ligjeve, në gjendje të mirë;
 2. BKT ka të gjithë autoritetin, kompetencat, pëlqimet, licensat dhe autorizimet e nevojshme dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të mundësuar që të lidhë këtë Marrëveshje dhe Kontratat;
 3. Kjo Marrëveshje dhe detyrimet janë detyruese për BKT-në dhe të zbatueshme ndaj saj në përputhje me kushtet dhe nuk do dhe nuk duhet të shkelin kushtet e ndonjë rregulloreje, urdhri, ose marrëveshje me të cilën BKT është lidhur;

16. PËRFUNDIMI

- 16.1. BKT ka të drejtë, pa dhënë ndonjë sqarim, të përfundojë ofrimin e shërbimeve të Platformës së Tregtimit SmartInvest për Klientë specifik, nëse sipas mendimit të arsyeshëm të BKT, Klienti keqpërdor dhe/ose përdor në mënyrë jo të duhur shërbimet e ofruara nga Platforma e Tregtimit SmartInvest ose Klienti nuk i respekton detyrimet e tij sipas Marrëveshjes ose detyrime të tjera që rrjedhin nga përdorimi i shërbimeve të Platformës së Tregtimit SmartInvest.
- 16.2. Në rast të ngjarjeve të përmendura në nenin 16.1, BKT ka të drejtë të:
1. Të kufizojë qasjen e Klientit në Platformën e Tregtimit SmartInvest;
 2. Të rregullojë komisionet dhe shpërndarjet në dispozicion të Klientit ose një Underlying Client, sipas rastit;
 3. Të transferojë nga cash ose Titujt e kredituara në llogarinë e Klientit në BKT çdo fitim tregtar me rëndësi që është fituar nga Klienti përmes një abuzimi të tillë (siç përcaktohet nga BKT); dhe/ose
 4. Të ndërmarrë çdo veprim tjetër që BKT konsideron të nevojshëm për të shmangur një sjellje të tillë.
- 16.3. Pavarësisht rasteve të parashikuara në nenin 16.2, BKT ka të drejtë të ndërpresë shërbimet e ofruara në Platformën e Tregtimit SmartInvest duke njoftuar paraprakisht (të paktën 10 ditë punë) Klientin.
- 16.4. Klienti ka të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje dhe përdorimin e Platformës së Tregtimit SmartInvest, duke mbyllur shërbimin e ofruar online, me kusht që Klienti të ketë mbyllur të gjitha pozicionet dhe ekspozimet e tij/saj në Platformë dhe pasi të jenë zgjidhur të gjitha Kontratat me datë valutë të përcaktuar. Para mbylljes së shërbimit online, Klienti mund të tërheqë të gjitha paratë "Cash i Disponueshëm" nga Platforma e Tregtimit SmartInvest në llogarinë e tij rrjedhëse.

17. TË NDRYSHME

- 17.1.** Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje mund të plotësohet ose ndryshohet nga publikime online në website të BKT-së ndërmjet Palëve, me kusht që:
1. BKT mund ta ndryshojë këtë Marrëveshje duke e njoftuar Klientin me shkrim jo më pak se 5 (pesë) Ditë Pune para ose duke postuar një njoftim të tillë në website jo më pak se 5 (pesë) Ditë Pune përpara se këto ndryshime të hyjnë në fuqi, nëse BKT konsideron, në mënyre të arsyeshme, se një ndryshim i tillë është i nevojshëm në përputhje me ndonjë Ligj të aplikueshëm, dhe;
 2. Në rast se ndryshimet janë bërë në përputhje me këtë klauzolë 17.1, Klienti do të konsiderohet se ka rënë dakord me to duke vazhduar të hyjë në Kontratë pas datës kur ndryshimet kanë hyrë në fuqi.
- 17.2.** Përveç nëse është rënë dakord ndryshe, asnjë nga Palët nuk ka të drejtë të transferojë ndonjë ose të gjitha të drejtat ose fitimet e saj në bazë të kësaj Marrëveshjeje.
- 17.3. Informimi**
Klienti do t'i sigurojë BKT çdo informacion dhe ndihmë që BKT e konsideron të nevojshme për t'iu përgjigjur në mënyrë të kënaqshme çdo pyetjeje ose kërkesë ose të bashkepunojë me ndonjë autoritet publik ose privat ose ndonjë këmbim përkatës ose treg në lidhje me aktivitetet dhe transaksionet e Klientit ose të Klientit Themelues përmes Platformës së Tregtimit Smart Investor të BKT.
- 17.4. Të Drejtat e Palëve te Treta**
Asnjë person që nuk është palë në këtë Marrëveshje nuk mund të zbatojë ndonjë kusht të kësaj Marrëveshjeje.
- 17.5. Paligjshmëria, pavlefshmëria dhe pazbatueshmëria**
Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje konstatohet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme sipas ndonjë ligji në fuqi, kjo dispozitë, për aq sa mund të ndahet nga dispozitat e mbetura, do të konsiderohet e fshirë nga kjo Marrëveshje dhe nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të mbetura.
- 17.6. Marrëveshja e plotë**
Kjo Marrëveshje përbën të gjithë Marrëveshjen midis Palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje paraprake midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Kjo marrëveshje nënshkruhet rregullisht nga të dy palët në gjuhën shqipe në dy kopje autentike, ku një kopje e merr Klienti.
- 17.7. Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni**
Kjo Marrëveshje rregullohet sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ekzekutimi dhe interpretimi i saj do të adresohet për zgjidhje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Palët nënshkruese

Banka

Klienti

SHEMBUJ

A – FOREX

Kur tregtohet në këmbime të huaja, investitori spekulon me ndryshueshmërinë e çmimit të një monedhe në krahasim me një tjetër, ku njëra shitet dhe tjetra blihet. Për shembull, një investitor mund të shesë paund Britanike (GBP) kundrejt dollarit Amerikan (USD), duke pritur që USD të rritet lidhur me GBP.

Këmbimi valutor tregtohet si një product marzh, që do të thotë se Klienti mund të investojë më shumë para sesa ka në dispozicion në llogarinë e tij/saj duke huazuar para nga BKT. Këmbimi valutor mund të tregtohet si FX. Këmbimi FX është blerja e një monedhe kundrejt shitjes së një tjetre për dorëzim në datën e transaksionit të këmbimit.

Tregu i këmbimit valuator është tregu më i madh financiar në botë me 24 orë tregtim gjatë gjithë ditëve të punës. Ndër të tjera, karakterizohet nga një marzh fitimi relativisht të ulët në krahasim me produktet e tjera. Pra fitimi i lartë varet nga volumi i madh i tregtimit, i cili arrihet nga tregtimi i marzhit, siç përshkruhet më sipër. Kur tregtohet në transaksione të këmbimeve valutore, fitimi i realizuar nga njëri lojtar i tregut (i zhveshur nga kostot si komisione dhe shpërndarje) do të kompensohet nga humbja e një lojtari tjetër. Transaksionet në këmbimet valutore do të bëhen gjithmonë nëpërmjet platformës BKT SmartInvest, si palë tjetër kjo nënkupton se çdo pozicion i hapur me platformën BKT SmartInvest mund të mbyllet vetëm nëpërmjet platformës BKT SmartInvest.

Duke qenë se këmbimi valuator i huaj është një transaksion me marzhin, i lejon klientit të marrë një pozicion më të gjerë sesa në të kundërt, Klienti bazuar në fondet tij/saj me BKT, një lëvizje relativisht e vogël negative ose positive e tregut mund të ketë një efekt disproporcionalisht të konsiderueshëm në investimin e Klientit.

Kjo mund të jetë sa e favorshme aq edhe e pafavorshme për Klientin. Kjo e bën fitimin potencial mjaft të lartë edhe nëse depozita është relativisht e vogël, por edhe mund të sjell humbje të konsiderueshme nëse transaksioni shkon në disfavorin tuaj. Nëse ekspozimi total i Klientit ndaj tregtimit me marzhin tejkalon depozitën e tij/saj, Klienti rrezikon të humbasë me shume sesa depozita e tij/saj. Janë dy lloje transaksioni Forex:

- 1- Spot Forex: Klienti mund të bëjë një transaksion me Forex nëpërmjet pozicionit të tij/saj në llogarinë e tij/saj (metodë klasike e këmbimit të vlerës midis llogarive tuaja apo dhe më para në zyrat e këmbimit valuator)
- 2- Leverage Forex: Leva është aftësia për të përdorur diçka të vogël për të kontrolluar diçka të madhe. Specifikisht për tregtimin me Forex, do të thotë që Klienti mund të ketë një sasi të vogël kapitali në llogarinë e tij/saj duke kontrolluar një sasi më të madhe në treg.

Klienti mund të bëjë një transaksion Forex nëpërmjet platformës “SmartInvest” dhe të përfitoj nga lëvrimi. Avantazhi i dukshëm i lëvrimit është se Klienti mund të bëjë një sasi të konsiderueshme parash, me një sasi të kufizuar kapitali. Problemi është se Klienti mundet gjithashtu të humbasë një sasi të konsiderueshme të parave duke tregtuar me lëvrim. Gjithçka varet nga zgjuarsia e Klientit në përdorimin e platformës dhe se sa konservator është Klienti.

I.E: Kursi EUR/USD paraqet numrin e Dollarëve Amerikane që një Euro mund të blejë. Nëse Klienti beson se Euro do të rritet në vlerë kundrejt Dollarit Amerikan, Klienti do të blejë Euro me Dollare Amerikane having a long position in EUR, short in US\$. Nëse kursi i këmbimit rritet, klienti do të shesë Eurot duke nxjerrë fitimin. Ju lutem kini kujdes pasi tregtia me Forex përfshin një rrezik të madh humbjeje. Nëse klienti përdor levën 1 me 10, do të thotë se për çdo 1 EUR që Klienti ka në llogarinë e tij/ saj, Klienti mund të vendosi një transaksion me vlerë 10 EUR. Për shembull, nëse Klienti ka depozituar 5,000 EUR, Klienti është i aftë të tregtojë deri në 50,000 EUR në treg duke përdorur nivelin 10:1. Klienti nuk është i detyruar të tregtojë me të gjithë shumën 50,000 EUR, por është i aftë të tregtojë deri në atë shumë.

Ja disa nga përfitimet kryesore të tregtimit me Forex:

- Klienti paguan vetëm për spreads (shpërndarjen) e kërkesë/ofertës dhe një komision të ulët.
- Veprimtaria e tregtisë zgjat 24 orë- Klienti vendos kur dhe si të tregtojë.
- Klienti mund të tregtojë me levrim, por kjo mund të zmadhojë fitimet dhe humbjet e mundshme.
- Klienti mund të përqendrohet në zgjedhjen e disa monedhave sesa në mijëra stocks (tituj) apo instrumenta derivative.
- Në sajë të lëvritimit, Forex është i aksesueshem – Klienti nuk ka nevojë për shume para për të filluar.

Tregtimi i këmbimit valutor të marzhit mbart një nivel të lartë riskut dhe mund të mos jetë i përshtatshëm për këdo. Përpara se të vendosë të tregtojë këmbime valutore të huaja, Klienti duhet që me kujdes, të marrë parasysh objektivat e tij/saj të investimit, nivelin e eksperiencës dhe se sa dëshiron të riskojë. Mos harroni, Klienti mund të pësojë humbje të një pjesë ose të të gjithë investimit të tij/saj fillestar, pra Klienti nuk duhet të investojë para, humbjen e të cilave nuk mund ta përballojë.

Për më shume detaje, ju lutem vizitoni platformën “Smart Invest”.

B – KËMBIMI I TITUJVE

Tregu i Titujve dhe Tregtimi i Aksioneve: Kompanitë të cilat i kanë listuar aksionet, të hapura për publikun (në krahasim me kompanitë private, aksionet e të cilave nuk janë të listuara në ndonjë treg këmbimi të titujve) mund të tregtohen nga investitorët, duke i dhënë investitorëve të drejtën për të marrë një pjesë të aksioneve të kompanisë. Kur Klienti blen tituj, Klienti bëhet aksioner, rrjedhimisht pronar të një “pjesë” të kompanisë. Në qoftë se fitimet e kompanisë rriten, Klienti merr pjesën e tij në ato fitime dhe përfiton prej tyre. Nëse fitimet e kompanisë bien, bie dhe çmimi i titujve të Klientit. Si aksioner, Klienti mund të përfitojë dhe nga shpërndarja e dividendit.

Aksionet në transaksionin e këmbimit mund të blihen ose shiten nga kushdo që ka një llogari në “Smart invest”. Aksionet blihen dhe shiten për të bërë fitim- i blen me 10\$ dhe i shet me 20\$, në këtë mënyrë Klienti dyfishon paratë e tij/ saj. Në një periudhë afatshkurtër, çmimet e aksioneve lëvizin rastësisht, bazuar në pritshmëritë afatshkurtra, por në një periudhë afatgjatë çmimet prirën të pasqyrojnë suksesin e kompanisë.

Me hapjen e një llogarie “Smart Invest” Klienti mund të tregtojë përafërsisht XXXX numër titujsh të ndryshëm në XX tregje kryesore, të ndryshëm të këmbimit të titujve.

Nëpërmjet “Smart Investor” Klienti mund të investojë në aksionet e General Electric, Apple, Nokia, Deutsche Bank, Daimler (Mercedes), Coca Cola etj, ose të bëjë disa transaksione spekuluese për të përfituar nga luhajtja afatshkurtër e çmimeve. Nëpërmjet llogarisë së “Smart Invest”, Klienti mund të shikojë në kohë reale detajet e transaksioneve tregtare me këmbim, në mënyrë që Klienti të ketë transparencë për volumin, çmimet dhe orientimin e aksioneve si dhe datën/orën e çdo transaksioni.

Klienti mund të bëjë një transaksion titujsh me platformën “Smart Invest” dhe të përfitojë nga levrimi duke përdorur CFD’ në (Contract for Differences). Avantazhi i dukshëm i përdorimit të CFD’se është se Klienti mund të bëjë një sasi të konsiderueshme parash, me një sasi të kufizuar kapitali. Problemi është se Klienti mundet gjithashtu të humbasë një sasi të konsiderueshme të parave duke tregtuar me levrim. Gjithçka varet nga zgjuarsia e Klientit në përdorimin e platformës dhe se sa konservator është Klienti.

The contract for difference (CFD) i ofron tregtarëve dhe investitorve një mundësi për të përfituar nga lëvizja e çmimeve pa qenë pronar të underlying asset (aktivi themelor). Është një titull relativisht i thjeshtë i llogaritur nga lëvizja e aktivitetit mes fillimit dhe daljes nga transaksioni, duke llogaritur vetëm ndryshimin e çmimit pa marrë parasysh vlerën themelore të aktivitetit. Kjo realizohet nëpërmjet një kontrate midis klientit dhe brokerit dhe nuk përdor asnjë stock (titull) (titull të bursës).

I.E: Nëse një stock (Titull) ka një çmim shitjeje 15.00 EUR dhe tregtari blen 100 aksione, kostoja e transaksionit do të jetë 1,500 EUR plus komisione e tarifa. Ky transaksion kërkon të paktën 1,500 EUR në cash nga brokeri tradicional, ndërsa broker i CFD shpeshherë kërkon vetëm 10% të marzhit, ose 150,00 EUR.- Një transaksion CFD do tregojë një humbje të barabartë me madhësinë e shpërndarjes në kohën e transaksionit, kështu që, nëse shpërndarja është 5 cent, titulli duhet të rritet me 5 cent në mënyrë që çmimi i shitjes të jetë i barabartë me kostot e blerjes dhe zotërimit të tij. Nëse do të zotëronit titullin plotësisht do të shikonit një fitim prej 5 centësh, por ama do të paguanit komision dhe do të shkaktonit një shpenzim më të madh të kapitalit.

Nëse titulli shkon në çmim oferte prej 16.50 EUR në një llogari tradicionale brokerimi, mund të shitet për 150 EUR fitim ose $150 \text{ EUR} / \$1500 = 10.0\%$ fitim. Megjithatë kur kembimi kombëtar arrin këtë çmim, çmimi i ofertes së CFD mund të jete vetëm 16.50 EUR.- Fitimi i CFD do të jete me i vogël sepse tregtari duhet të dale nga çmimi i ofertes dhe shpërndarja është me e madhe se në tregun e zakonshëm. Sipas kësaj shembulli tregtari i CFD fiton rreth 150EUR ose $150 \text{ EUR} / \$150.00 = 100\%$ kthim të investimit.

Tregtimi i titujve nëpërmjet CFD' së mbart një nivel të lartë riskut dhe mund të mos jetë i përshtatshëm për këdo. Përpara se të vendosni të tregtoni nëpërmjet CFD' së, duhet që me kujdes, të marrni parasysh objektivat tuaja të investimit, nivelin e eksperiencës dhe se sa dëshironi të riskoni. Mos harroni, mund të pësoni humbje të një pjesë ose të të gjithë investimit tuaj fillestar, pra nuk duhet të investoni para, humbjen e të cilave nuk mund ta përballoni.

Për më shumë detaje, ju lutem vizitoni platformën “SmartInvest”.

CFDs

Një CFD – ose Contract for Difference – është një spekulim në ndryshueshmërinë e vlerave. Produkti lejon Klientin të spekulojë në rritjen ose uljen në vlerë të një aktivi specifik në të ardhmen, ndër të tjera, forex, metalet e çmuara, indekset dhe aksionet, megjithatë duhet të theksohet se nuk do të ndodhë asnjë dorëzim fizik i aktivitetit themelor. Nëse spekulimet e Klientit vërtetohen të sakta, Klienti do të nxjerrë fitim nga diferenca në vlerë (më pak kosto), por nëse spekulimet vërtetohen të pasakta, Klientit i duhet të paguaj diferencën në vlerë (kosto shtesë). Duke qenë e lidhur me aktetivin themelor, vlera e CFD varet nga ai aktiv. CFD'te tregtohen gjithmone me marzh (shiko paragrafin me sipër për transaksionet e kembimeve të tuaja). CFD'të tregtohen nëpërmjet BKT që nënkupton se çdo pozicion i hapur me platformën BKT SmartInvest mund të mbyllet vetëm nëpërmjet platformës BKT SmartInvest.

C- Mallrat

Mallrat, pavarësisht nëse ato kanë të bëjnë me ushqimin, energjinë apo metalet janë një pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme. Kushdo që drejton një makinë mund të ndikohet ndjeshëm nga rritja e çmimit të naftës. Impakti i një thatësire mund të ndikojë direkte në përberjen e vaktit tuaj të ardhshëm. Ngjashmërisht, mallrat mund të jenë një menyrë e rëndësishme për të diversifikuar portofolin përtej titujve tradicional qoftë

për një afat të gjatë, ose si një vend për të mbajtur paratë gjatë periudhave të paqëndrueshme osë në rënie të tregut të titujve, pasi tregu i mallrave tradicionalisht lëvizin në kundërshtim me stocks (titujt).

Zakonisht janë parimet themelore të kërkesës dhe ofertës që drejtojnë tregun e mallrave: ulja e ofertës rrit kërkesën, që do të thote çmime më të larta, dhe anasjelltas. Ndërprerjet e mëdha në furnizim, të tilla si një frikë e përhapur shëndetësore midis bagëtisë, mund të çojnë në një rritje të kërkesës përgjithësisht të qëndrueshme dhe të parashikueshme për bagëtinë. Nga ana kërkesës, zhvillimi ekonomik global dhe përparimi teknologjik kanë një efekt me pak dramatik por të rëndësishëm tek çmimet. Shfaqja e Kinës dhe e Indisë si aktorë të rëndësishëm prodhues ka kontribuar në zvogëlimin e disponueshmërisë së metaleve industriale në pjesën tjetër të botës, siç është çeliku.

Mallra të tregtueshëm në “Smart Invest” hyjnë në kategoritë e mëposhtme:

- Metalet (ari, argjendi dhe bakri)
- Energjia (nafta për transport dhe për ngrohje)
- Bujqësore (sheqeri, misri, farat e sojes dhe kafeja)

Një menyre e njohur për të investuar në mallra është nëpërmjet kontratës së ardhme.

D – FUTURES

Kontrata Futures: Një kontratë e ardhme, është një marrëveshje për blerjen ose shitjen e një sasive të caktuar malli apo aktivi në një çmim të caktuar në të ardhmen. Futures janë të disponueshme për çdo kategori malli apo aktivi.

Çdo kontratë e ardhme kërkon një depozitë të ndryshme minimale dhe vlera e llogarisë suaj do rritet ose ulet sipas vlerës së kontratës. Nëse vlera e kontratës ulet, ju do të jeni subjekt i një margin call dhe do t’ju kërkohet të vendosni më shumë para në llogarinë tuaj të “Smart Invest” për të mbajtur pozicionin e hapur ose llogaria juaj mund të mbyllet automatikisht për shkak të humbjeve. Për arsye të numrit të lartë të levrimeve, lëvizjet e vogla të çmimeve mund të nënkuptojnë fitime ose humbje të mëdha dhe fshirjen e plotë apo dyfishimin e llogarisë futures brenda pak minutash.

Tregtimi nëpërmjet kontratave të ardhme mbart një nivel të lartë riskut dhe mund të mos jetë i përshtatshëm për këdo. Përpara se të vendosni të tregtoni nëpërmjet kontratave futures, duhet që me kujdes, të marrni parasysh objektivat tuaja të investimit, nivelin e eksperiencës dhe se sa dëshironi të riskoni. Mos harroni, mund të pësoni humbje të një pjesë ose të të gjithë investimit tuaj fillestar, pra nuk duhet të investoni para, humbjen e të cilave nuk mund ta perballoni.

Për më shumë detaje, ju lutem vizitoni platformën “SmartInvest”.

E – Tregtimi i Marzhit

Transaksionet me lëvrim në forex, tituj dhe mallëra bëhen nëpërmjet një llogarie margin (marzhi) duke blerë me marzh. Blerja me marzh është huamarrja nëpërmjet llogarisë së “Smart Investor” për të blerë me shumë aktive (Forex, Mallra, Tituj) sesa ju lejon buxheti juaj aktual. Klienti mund ta kuptojë si një kredi e marrë nga llogaria e tij. Tregtia me marzh e lejon Klientin të blejë më shumë aktive sesa do ishte në gjendje të blinte normalisht.

Klienti mund ta mbajë huanë e tij/saj për sa kohë të dojë nëse plotëson detyrimet e tij/saj. Së pari, kur Klienti shet aktive (Forex, tituj apo mallra) në një llogari marzh, të ardhurat fillimisht shkojnë për shlyerjen e kredisë së marzhit deri kur të paguhet plotësisht. Së dyti, ekziston gjithashtu një kufizim i quajtur marzhi i mirëmbajtjes, i cili është bilanci minimal i llogarisë që Klienti duhet të ruaj përpara se të detyrohet të depozitojë më shumë fonde apo të mbyllë pozicionin për të shlyer kredinë. Kur ndodh kjo, do të quhet margin call.

Huamarrja nuk është pa kosto. Për fat të keq aktivet e margjinalizuara në llogari janë kolateral. Klientin do ti duhet të paguaj gjithashtu interesin për kredinë. Tarifat e interesit do të aplikohen në llogarinë e Klientit, përveç nëse Klienti vendos të bëjë pagesa. Me kalimin e kohës niveli i borxhit të Klientit rritet pasi tarifat e interesit grumbullohen rreth tij. Ndërsa borxhi rritet, tarifat e interesit rriten gjithashtu, etj. Prandaj blerja në marzh përdoret kryesisht në investime afatshkurtra. Sa më gjatë që klienti ta mbajë investimin, aq më i madh do të jetë fitimi i nevojshëm për të kaluar në pozicionin e balancuar (Break Even) (as fitim as humbje). Në tregtimin e titujve, BKT do ti kujtojë Klientit që jo të gjithë titujt kualifikohen për tu blerë në marzh. Në SH.B.A autoriteti rregullator, Bordi i Rezervës Federale rregullon se cilët tituj janë të margjinalizueshëm.

Shembull i një Margin Call

Një investitor blen 10,000 EUR (nga titujt) stocks e një kompanie duke përdorur 5,000 EUR nga fondet e tij dhe duke marrë hua pjesën e mbetur 5,000 EUR nga llogaria “Smart-Invest”. Le të supozojme se llogaria e “Smart Invest” kërkon një marzh te mirëmbajtjes 25%. Në momentin e blerjes, raporti i marzhit fillestar të investitorit si përqindje është 50%.

Marzhi fillestar i investitorit në përqindje = (Vlera në Treg e Titujve – Fondet e Huazuara) / Vlera në Treg e Titujve

Në shembullin tonë: $50\% = (10,000 \text{ EUR} - 5,000 \text{ EUR}) / (10,000 \text{ EUR})$

Kjo është mbi 25% të marzhit të mirëmbajtjes, por supozojmë se në ditën e tretë të tregimit, vlera e titujve të blerë të bjerë nga 10,000 EUR në 6,000 EUR. Kjo ben që raporti i marzhit aktual të investitorit të bjerë 16.67% dhe paratë e investitorit të bien në 1,000 EUR nga 5,000 EUR.

$16.67\% = (6,000 \text{ EUR} - 5,000 \text{ EUR}) / (6,000 \text{ EUR})$

Paratë e Investitorit bien tanimë në 1,000 EUR

$5,000 \text{ EUR (Shuma fillestare e investuar)} - 4,000 \text{ EUR (humbje në tituj)} = 1,000 \text{ EUR}$

Kjo rënie në çmimin e titujve i shkakton raportit të marzhit të investitorit të jetë nën marzhin e mirëmbajtjes prej 25%. Llogaria e “B-Investor” bën një margin call, duke i kërkuar investitorit të bejë një depozitim prej 500 EUR për të përmbushur marzhin e mirëmbajtjes. Shuma e kërkuar për të përmbushur marzhin e mirëmbajtjes llogaritet kështu:

Shuma për të Përmbushur Marzhin Minimal të Mirëmbajtjes = (Vlera në Treg e Titujve “Securities” x Marzhi i Mirëmbajtjes) – Paratë e mbetura të investitorit.

Në shembullin tonë, 500 EUR e kërkuara llogariten kështu:

$500 \text{ EUR} = (6,000 \text{ EUR} \times 25\%) - 1,000 \text{ EUR}$

Investitorit i duhen të paktën 1,500 EUR (Vlera në treg e titujve “securities” 6,000 EUR shumëzim 25% të marzhit të mirëmbajtjes) në llogarinë e tij për të qenë i pranueshëm për marzhin, por i kanë mbetur vetëm 1,000 EUR në paratë e investitorit duke sjell 500 EUR deficit. The margin call është për 500 EUR dhe nëse investitori nuk i depoziton paratë në afatet e caktuara, llogaria e “Smart Invest” mund të shesë e likuidojë tituj (securities) në vlerën e nevojshme për ta sjelle llogarinë në përputhje me rregullat e marzhit të mirëmbajtjes.

Për sa më sipër tregtimi me levrin nepërmjet marzhit mbart një nivel të lartë riskut dhe mund të mos jetë i përshtatshëm për këdo. Përpara se të vendosë të tregtojë me levrin, Klienti duhet që me kujdes, të marrë parasysh objektivat e tij/saj të investimit, nivelin e eksperiencës dhe se sa dëshiron të riskojë. Mos harroni, Klienti mund të pësojë humbje të një pjesë ose të të gjithë investimit të tij/saj fillestar, pra Klienti nuk duhet të investojë para, humbjen e të cilave nuk mund ta përballojë.

Për më shume detaje, ju lutem vizitoni platformën “SmartInvest”.

Palët

Banka

Klienti

Data
